



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:041790

Datë: 19.11.2019

Numri i dokumentit: 00657398

**P.nr.1001/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, dhe zyrtaren ligjore Lavdije Brahimi Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit S.O nga ....., për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nen par.1.4 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.67-5/2016, e dt. 24.07.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Mimoza Syla Hysnei, si dhe të pandehurit Sami, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.14.08.2019 dhe shqyrtimit gjyqësor të dt.08.11.2019, mori dhe publikisht komunikoi ndërsa me dt.19.11.2019 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** S. O i lindur me ....., nga fsh. ....Komuna Ferizaj, nga i ati E... dhe e ema T.... e vajzërisë Sh..., i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor fizik, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 4 fëmijëve, me numër personal ..... Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

Me dt.01.01.2016, rreth orës 05:00, në fshatin ....., Komuna Ferizaj, saktësisht në lagjen e tyre, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit F . B në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve rreth hedhjes së bërllokut nga i dëmtuari, i pandehuri fillimisht pas një fjalosje verbale e godet me një dru në trup mjek ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, e pastaj e godet me shqelm në trup në mes të

këmbëve duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizën mjekoligjore të dt. 15.07.2018,-

**me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nen par.1.4 të KPRK-së.**

**Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 7, 8, 9, 17, 21, 41, 73, 74, 85 dhe 86, dhe 188 të KPRK-së, si dhe , nenit 498,499 të KPPK-së, të pandehurin i shqipton:**

### **VËREJTJE GJYQËSORE**

- I pandehuri u njoftua se vepra e tillë përbën vepër penale, vepër e dëmshme dhe e rrezikshme, si dhe nëse i njëjti prapë kryen vepër të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.**
- I dëmtuari F.B nga fshati..... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.**
- I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale për shkak te gjendjes se renduar ekonomike dhe te njëjtat shpenzime bien mbi barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.**

### **A r s y e t i m i**

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari te vetëm gjykues.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.67-5/2016 e dt. 24.07.2019 ka ngarkuar të akuzuarin S.O për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2

lidhur me par.1 nen par.1.4 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 08.11.2019 në të cilën shqyrtim gjyqësor: i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, shpreh keqardhje dhe është penduar thellë, i njëjti shton se është hera e parë që ndeshet me ligjin, premtion gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Prokurorja e Shtetit Mimoza Syla duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat dhe shkresat që përmban aktakuza, prandaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh pranimin e fajësisë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 lidhur me nenin 326 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht; pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë deklarata e të dëmtuarit, ekspertiza mjeko ligjore e dt. 15.07.2018, raportet mjekësore si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nen par.1.4 të KPRK-së, për të pandehurin S.O të kryer në mënyrën dhe

rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe atë veprimet e kundërligjshme te kryera nga i pandehuri me çka rezulton nga tërësia e rrethanave te kryerjes se veprës penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të pandehurit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, pendimin, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, baba i 4 fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, pa pune, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi bazë të këtyre rrethanave i shqiptoj vërejtje gjyqësore si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konfrom nenit 458-459 i dëmtuari F.B nga ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale është marre ne kuptim te nenit 453 par.4 te KPPK-se

**Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**

**P.nr.1001/18, me dt. 19.11.2019**

**Zyrtare Ligjore,  
Lavdije Brahimi Aliu**

**Gjyqtari:  
Hakile Ilazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.